

PROJEKT – LIGJ
PER ZHVILLIMIN RAJONAL NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

I. DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Neni 1
(Qellimi)

Ky Ligj percakton objektivat, parimet, instrumentat dhe kuadrin institucional per menaxhimin e zhvillimit rajonal dhe nxitjen e nje zhvillimi rajonal te ekuilibruar ne Republiken e Shqiperise.

Neni 2
(Objekti i Ligjit)

Objektivat themelore te ketij Ligji jane:

- Nxitja e zhvillimit te qendrueshem dhe te ekuilibruar te te gjithe rajoneve te Shqiperise;
- Forcimi i konkurrueshmërisë së ekonomisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe vlerësimin e diferencave lokale dhe rajonale;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës në të gjitha rajonet e Republikës së Shqipërisë;
- Reduktimi i vazhdueshëm i diferencave te zhvillimit ekonomik dhe social duke nxitur zhvillimin e integruar te zonave rurale dhe nje zhvillim te ekuilibruar ndermjet rajoneve te Republikës se Shqiperise;
- Rigjallërimi i zonave me dizavantazhe te theksuara (te izoluara nga zhvillimi);
- Parandalimi i emergjencave qe mund te krijohen nga zhbalecimet e reja gjate procesit te zhvillimit te vendit;
- Krijimi i nje platforme politike dhe ligjore me baze te gjere per zhvillimin e balancuar te Rajoneve, qe do te parandaloje aplikimin e politikave te deformuara dhe preferenciale ne ceshtjet e zhvillimit ekonomik dhe social te Rajoneve.
- Krijimi dhe zhvillimi i nje kuadri unik per planifikimin dhe menaxhimin eficient te zhvillimit rajonal;
- Nxitjen e bashkepunimit nderrajonal te brendeshem dhe nderkombetar, te bashkepunimit nderkufitar brenda kuadrit te Eurorajoneve si edhe te pjesmarrjes ne organizatat dhe strukturat Europiane.

Neni 3
(Perkufizime)

Ne kete Ligj termat e meposhteme kane keto kuptime:

1. *Politika e zhvillimit kombëtar* nenkupton një paketë integrale dhe të bashkërenduar objektivash, prioritetesh, aktiviteteve dhe masash të orientuara drejt arritjes së zhvillimit të qëndrueshëm, social dhe ekonomik të Republikës së Shqipërisë.
2. *Zhvillim rajonal* është një proces afatgjatë i rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik që do të arrihet nëpërmjet identifikimit, stimulimit dhe menaxhimit të potencialit të zhvillimit të rajoneve individuale.
3. *Rajon* do te nenkuptohet nje teresi territoriale ne vazhdimesi, qe perfshin nje numur njesish administrative territoriale te qeverisjes vendore.

4. *Zona e pafavorizuar* është çdo pjesë e Republikës së Shqipërisë që është vlerësuar, sipas kritereve që përmbahen në ligj, si zona që në kuptimin social dhe ekonomik mbetet mbrapa mesatares kombëtare dhe zhvillimi i të cilave duhet të nxitet në mënyrë të veçantë.
5. *Dokumentet planifikuese* janë: Strategjia Kombetare e Zhvillimit, Strategjia Ndersektorale per Zhvillimin Rajonal, Strategjitë e Zhvillimit Sektorial, Strategjitë e Zhvillimit të Qarqeve dhe dokumentet e zbatimit të tyre (planet e veprimit, etj).
6. *Projekt zhvillimi* është një projekt ndërtimi dhe/ose rindërtimi i infrastrukturës së shërbimeve, ekonomike dhe infrastrukturave të tjera të zhvillimit të qëndrueshëm; e ndërtimit dhe/ose fuqizimit (forcimit) të institucioneve edukative, kulturore, shkencore dhe të tjera; e forcimit dhe krijimit të kapitalit social, si dhe çdo projekt ekonomik dhe tjetër që mund të kontribuojë në zhvillimin rajonal.
7. *Ministri* është ministria përgjegjëse për zhvillimin rajonal;
8. *Ministër* është ministri përgjegjës për zhvillimin rajonal.
9. *Qeveri* është Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

(Parimet e politikës së zhvillimit rajonal në Republikën e Shqipërisë)

Parimet e nxitjes së zhvillimit rajonal janë:

- *Partneriteti dhe bashkëpunimi* :

Partneriteti në formën e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publikë, private dhe civilë dhe veçanërisht ndërmjet organeve shtetërore administrative qendrore dhe organeve administrative vendore.

- *Solidariteti dhe përqendrimi*

Stimulimi i zhvillimit të zonave të pafavorizuara bazohet në solidaritetin e përbashkët të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe orientohet veçanërisht drejt mbeshtetjes shtesë të zonave që kanë mbetur shumë mbrapa mesatares kombëtare.

- *Mundësi të barabarta*

Politika e zhvillimit rajonal bazohet në domosdoshmërinë e krijimit të kushteve të jetesës në të cilat të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për të zhvilluar potencialin e tyre.

- *Planifikimi dhe Programimi*

Planifikimi dhe programimi i zhvillimit rajonal bazohet në dokumentet shumëvjeçare të planifikimit, të cilët përmbajnë një ose më shumë programe zhvillimi që mundësojnë realizimin e objektivave dhe prioritetëve bazë të deklaruara nga dokumentet e planifikimit.

- *Bashkimi i fondeve dhe bashkefinancimi*

Financimi i dokumenteve të planifikimit dhe projekteve të zhvillimit të balancuar rajonal sigurohet nëpërmjet bashkefinancimit nga buxhetet vendore, buxheti kombëtar, burimet private dhe të tjera. Burimet financiare që do të jenë në dispozicion të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet fondeve të Bashkimit Europian nuk do të ulin nivelin e burimeve financiare kombëtare të drejtuara drejt financimit të aktiviteteve të zhvillimit.

- *Monitorimi dhe vlerësimi*

Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal me qëllim rritjen e efikasitetit, eficiencës dhe ndikimit mbi zhvillimin.

- *Qëndrueshmëria*

Politika e zhvillimit rajonal kontribuon në një zhvillim të rregullt dhe të ekuilibruar social dhe ekonomik, që mbron dhe ruan ambientin natyror si dhe lirinë e trashëgimisë kulturore të Republikës së Shqipërisë.

- *Informimi dhe transparencja*

Cdo person ka të drejtë të njihet, sipas dispozitave të këtij Ligji, me dokumentet e planifikimit të hartuara dhe procedurat për përzgjedhjen dhe financimin e projekteve të zhvillimit.

- *Autonomia vendore*

Politika e zhvillimit rajonal respekton autonominë administrative të qarkut dhe komunës/bashkisë që garantohet nga rendi juridik i Republikës së Shqipërisë dhe Karta Europiane e Autonomise Vendore dhe që mbështetet në parimin e subsidiaritetit.

II. DOKUMENTET PLANIFIKUESE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE.

Neni 5

(Dokumentet Planifikuese Baze te Republikes se Shqiperise)

Dokumentet Planifikuese Baze ne Republikën e Shqiperise jane:

- Strategjia e Kombetare e Zhvillimit;
- Strategjitë dhe Programet e Zhvillimit Sektorial te pergatitura nga Ministritë e linjes;
- Strategjite Ndersektoriale;
- Projekt Buxheti Afat – mesem;

Neni 6

(Dokumentet Planifikuese per Zhvillimin Rajonal ne Republikën e Shqiperise)

(1) Dokumentet planifikuese per Zhvillimin Rajonal ne Republikën e Shqipërisë janë:

- Strategjia Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal dhe dokumenti i zbatimit te saj (këtu SNZHR dhe Plani Veprimit per SNZHR) perbejne dokumentin e planifikimit ne nivel kombetar;
- Strategjite dhe Programet e Zhvillimit të Qarqeve dhe dokumentet e zbatimit te tyre (këtu SZHQ dhe Plani Veprimit per SZHQ) perbejne dokumentin e planifikimit ne nivel qarku;
- Programet e Perbashketa te Zhvillimit.

(2) Dokumentet e planifikimit sipas paragrafit te pare hyjnë në fuqi për një periudhë disa-vjeçare.

(3) Qeveria përcakton strukturën e dokumenteve të planifikimit në nivel kombëtar, përmbajtjen e tyre detyruese, metodologjinë e hartimit dhe çështje të tjera që lidhen me to.

(4) Dokumentet e planifikimit publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në gazetë zyrtare të organeve të pushtetit vendor.

Neni 7

(Strategjia Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal ne Republikën e Shqipërisë)

(1) SNZHR-ja përcakton politiken, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit rajonal të Republikës së Shqipërisë në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit.

(2) SNZHR është dokumenti baze për përgatitjen e Strategjive dhe Programeve Rajonale dhe të Perbashketa të Zhvillimit.

(3) Objektivat e SNZHR merren parasysh në përgatitjen e Programeve Sektoriale të Zhvillimit nga çdo ministri përgjegjës për ato programe dhe në përgatitjen e akteve kombëtare të zhvillimit hapsinor.

Neni 8

(Pergatitja e Strategjise Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal)

(1) SNZHR-ja adoptohet nga Qeveria me propozimin e ministrit.

(2) Dokumenti i SNZHR i hartuar sipas dispozitave të këtij ligji miratohet nga Qeveria pas një procesi konsultimesh me Këshillin e Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal.

Neni 9

(Raportimi per Strategjine Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal)

- (1) Ministri duhet ti paraqese raporte vjetore Qeverise mbi realizimin e Strategjise Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal dhe politikese rajonale ne Shqiperi.
- (2) Qeveria i paraqet raporte vjetore Kuvendit mbi zbatimin e ketij Ligji dhe realizimin e objektiveve te Strategjise Ndersektoriale per Zhvillimin Rajonal.

Neni 10

(Strategjia e Zhvillimit të Qarkut)

- (1) Strategjia e Zhvillimit të Qarkut është dokumenti i planifikimit të autoritetit të qeverisjes vendore të qarkut. Ajo koordinon parashikimet dhe detyrat e qeverise dhe të bashkive/komunave për zhvillimin ekonomik, social, ambiental, hapsinor, dhe kulturor të rajonit (qarkut), duke konsideruar dhe harmonizuar strategjite dhe programet sektoriale të zhvillimit me ato vendore.
- (2) Drejtimet bazë të zhvillimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut përcaktohen në përputhje me objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të përcaktuara në dokumentet e planifikimit në nivel kombëtar. Për qëllimin e zbatimit të efektshëm të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, Këshilli i Qarkut miraton dokumente zbatimi (plan veprimi, program zhvillimi). Dokumentet e zbatimit publikohen në gazetën zyrtare të Këshillit të Qarkut.
- (3) Struktura e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, përmbajtja e saj detyruese, metodologjia e hartimit dhe vlerësimit, dhe çështjet e tjera përkatëse përcaktohen me vendim qeverie.
- (4) Dokumentet e planifikimit të hartuara sipas dispozitave të këtij ligji miratohen pas një procesi konsultimesh me Këshillin e Partneritetit të Qarkut përkatës.
- (5) Këshillat e Qarkut janë të detyruar të harmonizojnë çdo plan ekzistues të zhvillimit rajonal, të miratuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me dispozitat e tij dhe aktet nenligjore bazuar në të, brenda 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të tyre.

Neni 11

(Zbatimi i dokumenteve planifikuese)

- (1) Veprimtaritë e nevojshme për zbatimin efektiv të dokumenteve planifikues të hartuar sipas dispozitave të këtij Ligji, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e tyre, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Këshilli i Ministrave.
- (2) Aktet nenligjore publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 12

(Cikli planifikues)

- (1) Dokumentet planifikuese adaptojnë ciklin planifikues që përdoret nga Bashkimi Europian për fondet Strukturore. Kjo asiston procesin e aderimit në BE. Brezi i parë i dokumenteve planifikuese të hartuara sipas dispozitave të ligjit miratohen për periudhën deri më 2013.

III AUTORITETET E POLITIKES RAJONALE.**Niveli Qendror****Neni 13**

(Organet përgjegjëse për politikën rajonale)

- (1) Organet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës rajonale sipas këtij Ligji janë Qeveria, Ministria dhe Agjencia Kombetare për Zhvillimin Rajonal.
- (2) Organet pjesmarrese në përgatitjen dhe zbatimin e politikës rajonale të zhvillimit janë Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillim Rajonal, organet përkatëse shtetërore, si dhe organet e tjera publike, aktivitetet e të cilëve kontribuojnë për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit rajonal.

Neni 14

(Agjencia Kombetare për Zhvillimin Rajonal)

- (1) Agjencia Kombetare për Zhvillimin Rajonal (me poshte AKZHR) është person juridik në vartësi të ministrisë, në cilësinë e një autoriteti ekzekutiv dhe ngrihet (formohet) për nxitjen dhe koordinimin e politikës rajonale të zhvillimit.
- (2) Statuti, selia, forma e organizimit dhe funksionimit, si dhe financimi i AKZHR-se miratohen me vendim të Qeverisë, me propozimin e ministrit.
- (3) Përgjegjësitë dhe detyrat kryesore të Agjencisë Kombetare për Zhvillimin Rajonal janë:
 - a) Përpunimi i Strategjisë ndersektorale për Zhvillimin Rajonal dhe Programeve Kombetare për Zhvillimin Rajonal;
 - b) Përpunimi i parimeve, kritereve, prioritetëve dhe menyrës së alokimit të burimeve financiare për zbatimin e Programeve Kombetare për Zhvillimin Rajonal;
 - c) Nxitja e formave të ndryshme të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të Qeverisë Vendore brenda një qarku, ndërmjet qarqeve, ndërmjet rajoneve nderkufitare dhe me gjere.
 - d) Të sigurojë asistencën e duhur Këshillave të Qarqeve dhe Agjencive të Zhvillimit të Qarqeve për ngritjen e kapaciteteve të tyre institucionale, si edhe në formulimin dhe negocimin e Marrëveshjeve të Zhvillimit të Qarqeve me ministritë e linjes.
 - e) Të menaxhojë fondet që alokohen për Zhvillimin Rajonal nga burimet financiare të Qeverisë Shqiptare dhe financime të huaja.

Neni 15

(Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal)

- (1) Këshilli i Partneritetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal është një organ konsultativ e keshillimor i Ministrit për programimin, zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe bashkërendimin e përgjithshëm të politikës kombëtare të zhvillimit rajonal (këtu 'KPK').
- (2) Anëtarësia e 'KPK'-së caktohet nga Ministri sipas propozimeve nominale të drejtuesve të institucioneve dhe organizatave në përberje të tij. Detyrat administrative të nevojshme për funksionimin e Këshillit kryhen nga ministria.
- (3) Raporti i antaresisë së 'KPK' është:
 - një e treta nga sektori publik në nivel qendror;
 - një e treta nga sektori publik në nivel rajonal dhe lokal;
 - një e treta nga sektori privat, shoqëria civile dhe institucione akademike dhe shkencore.
- (4) 'KPK' drejtohet nga ministri.
- (5) Përbërja, objekti dhe aktivitetet e KPK-së dhe çështje të tjera rregullohen me vendim të Qeverisë.

KPK debaton dhe jep dhe sugjerime në lidhje me dokumentet e planifikimit në nivel kombëtar në kontekstin e përgatitjes, formulimit dhe zbatimit të tyre. KPK mund të rregullojë detaje në lidhje me aktivitetet e tij, vendim-marrjen dhe çështje të tjera të rëndësishme nga rregullat e procedurës. Rregullat e procedurës miratohen nga ministri.

Niveli rajonal dhe lokal (i qarkut dhe bashkisë/komunës)

Neni 16

(Bashkëpunimi në nivel qarku)

(1) Në procesin e hartimit dhe zbatimit të politikës së zhvillimit rajonal në nivel qarku, Ministria dhe organet e tjera të administratës publike qendrore bashkëpunojnë me Keshillin e Qarkut dhe këshillat e bashkive/komunave në territorin e tij.

Neni 17

(Organet përgjegjëse për strategji dhe programet e zhvillimit të qarkut)

(1) Organet përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e strategjisë dhe programit të zhvillimit të qarkut, sipas këtij Ligji, janë Keshilli i Qarkut dhe Agjencia e Zhvillimit të Qarkut.

(2) Organet që marrin pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë dhe programit të zhvillimit të qarkut janë Këshilli i Partneritetit të Qarkut si dhe organet e tjera publike aktivitetet e të cilëve kontribuojnë për realizimin e objektivave të politikës së zhvillimit të qarkut.

Neni 18

(Roli i Këshillit të Qarkut)

Keshilli i Qarkut ka keto detyra:

- (1) Harton dhe miraton Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut;
- (2) Themelon Keshillin e Partneritetit të Qarkut dhe bashkëpunon me këshillat e bashkisë/komunës në planifikimin e zhvillimit të qarkut;
- (3) Nënshkruan Marrëveshjen e Zhvillimit të Qarkut me ministrin;
- (4) Kryen detyra të tjera që nxisin zhvillimin ekonomik dhe social të qarkut.

Neni 19

(Agjencia e Zhvillimit të Qarkut)

(1) Për menaxhimin efektiv dhe stimulimin e zhvillimit të territorit të tij, Keshilli i Qarkut mbështetet në strukturën e tij administrative ose themelon (ngre) Agjencinë e Zhvillimit të Qarkut.

(2) Agjencia e Zhvillimit të Qarkut themelohet si një subjekt juridik jo-fitimprurës. Bashkitë dhe komunat brenda territorit të qarkut marrin pjesë në themelimin e kësaj Agjencie.

(3) Agjencia e Zhvillimit të Qarkut ka keto detyra:

- a) jep një bazë analitike dhe profesionale për përgatitjen, hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut dhe dokumente të tjera planifikuese në nivel qarku;
- b) përgatit dhe zhvillon projekte dhe sugjerime paraprake; bashkërendon aktivitetet e Këshillit të Partneritetit të Qarkut;
- c) bashkërendon aktivitetet e institucioneve të zhvillimit në qark, që janë përfshirë në zbatimin e dokumenteve të zhvillimit në nivel rajonal;
- d) bashkëpunon me agjenci të tjera zhvillimi të qarkut; bashkërendon zbatimin e Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut në territorin e qarkut;

- e) bën analiza të efekteve të masave të politikës së zhvillimit rajonal;
- d) kryen detyra të tjera që sigurojnë zbatimin e politikës së zhvillimit rajonal dhe stimulojnë zhvillimin ekonomik dhe social në qark.

(4) Drejtori i Agjencise se Zhvillimit te Qarkut perzgjidhet nepermjet nje procesi transparent konkurimi. Emerimi dhe shkarkimi i tij behet nga Keshilli i Qarkut, me propozimin e Kryetarit te Keshillit te Qarkut.

Neni 20

(Këshilli i Partneritetit të Qarkut)

(1) Këshilli i Partneritetit të Qarkut (këtu 'KPQ') është organi konsultativ dhe keshillimor në nivel qarku, që themelohet me qëllim: konsultimi gjatë procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut dhe dokumenteve të tjera të planifikimit të qarkut; bashkërendimi të subjekteve të ndryshme dhe stimulimi të pjesëmarrjes së tyre në planifikimin e zhvillimit në territorin e qarkut të tyre.

(2) Anëtarësia e Këshillit të Partneritetit të Qarkut caktohet nga Keshilli i Qarkut me propozim te Kryetarit te Keshillit të Qarkut dhe merret nga anëtarët e Këshillit të Qarkut, këshillat e bashkive/komunave brenda territorit të qarkut; organet administrative shtetërore nga territori i qarkut dhe përfaqësuesit e biznesit, shoqatat e punemarresve dhe shoqëria civile nga territori i qarkut, aktivitetet e të cilin orientohen drejt stimulimit të zhvillimit social dhe ekonomik.

(3) Raporti i perberjes se antaresise se 'KPQ' do te jete:

- një e treta nga sektori rajonal dhe lokal publik ne perberje te qarkut;
- një e treta nga sektori privat dhe partnerët e tjerë socialë qe ushtrojne aktivitet ne qarkun perkates: Dhomat e tregtisë, shoqatat e punemarresve dhe shoqatat e punëdhënësve;
- një e treta nga sektori vullnetar i shoqerise civile dhe komunitetet.

(3) Detyrat administrative dhe profesionale të nevojshme për aktivitetet e Keshillit te Partneritetit të Qarkut kryhen nga njësia përkatëse e administratës së qarkut ose Agjencia e Zhvillimit të Qarkut.

Neni 21

(Akreditimi dhe regjistri i Agjencisë së Zhvillimit të Qarkut)

- (1) Ministria akrediton Agjencitë e Zhvillimit të Qarqeve në pajtim me kriteret e caktuara akreditimi që bëhen publike.
- (2) Ministria mban një regjistër të Agjencive të Akredituara të Qarqeve dhe mbikqyr aktivitetet e tyre lidhur me zbatimin e Strategjisë dhe të këtij Ligji.

IV MARREVESHJA E ZHVILLIMIT TE QARKUT

Neni 22

(Qëllimi i Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut dhe permbajtja e saj)

(1) Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut formalizon detyrimin e organeve te pushtetit qendror dhe vendor, për të financuar së bashku zbatimin e Planit të Veprimit mbi Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut.

(2) Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut permban:

- Detyrimin e palëve në Marrëveshjen e Zhvillimit të Qarkut, siç përcaktohet ne piken (3) te ketij neni;

- Kontributet financiare te paleve per zbatimin e Planit të Veprimit për Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut;
 - Periudhen e vlefshmërisë të Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut. Kjo duhet të jetë në pajtim me ciklin e buxhetit shumë-vjeçar të qeverisë.
 - Detyrimet në lidhje me vlerësimin e arritjeve të Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarkut dhe të qëllimeve të paracaktuara.
- (3) Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut mbahet ndërmjet Këshillit të Qarkut dhe ministrive të linjes.

Neni 23

(Palët në Marrëveshje)

(1) Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut është një akt bashkepunimi ndërmjet Qeverisë, Këshillit të Qarkut dhe këshillave të bashkisë/komunës brenda qarkut, që i detyron palët të zbatojnë angazhimet e tyre reciproke për realizimin e Planit të Veprimit.

(2) Për çdo qark bëhet një Marrëveshje e Zhvillimit të Qarkut. Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut përmban në vecanti elementet e mëposhtme:

- Kontributin e saktë dhe të vlerësuar individual financiar të një ministrie, Këshilli Qarku ose këshilli Komune/Bashkie në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit dhe për çfarë duhet të përdoret ai përkushtim financiar.
- Bazën e shpenzimit të përkushtimit financiar të ministrisë, Këshillit të Qarkut ose Bashkisë/Komunës (shpenzimi i drejtpërdrejtë nga qeveria qendrore, bashkë-financimi për shpenzimet e njësisë së qarkut/lokale vetë-qeverisëse, përdorimi i deleguar i financave të buxhetit kombëtar nga autoritetet e qarkut/bashkiake etj).
- Procedurat, të dhënat dhe afatet kohore për raportimin mbi zbatimin e veprimeve të financuara dhe përdorimi i fondeve të alokuara.
- Procedurat dhe afatet kohore për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të veprimeve të financuara dhe përdorimi i fondeve të alokuara.

Neni 24

(Procedurat kryesore të miratimit të Marrëveshjes së Qarkut)

(1) Marrëveshjet e Zhvillimit të Qarqeve përfshihen në planifikimin afat-gjate të buxhetit të shtetit (që i siguron atyre financim zbatues).

(2) Faza e parë e negociimit të Marrëveshjeve të Zhvillimit të Qarqeve zhvillohet gjatë procesit të formulimit dhe aprovimit të buxhetit shumë-vjeçar të shtetit, për të alokuar brenda buxheteve individuale ministrore financimin e nevojshëm të Qeverisë për zbatimin e sejcilit prej Planeve të Veprimit të Strategjive të Zhvillimit të Qarqeve.

(3) Marrëveshjet e Zhvillimit të Qarqeve nënshkruhen nga:

- a) Ministria e Financave në emër të Qeverisë.
- b) Këshillat e Qarqeve në emër të autoriteteve të Qeverisjes Vendore në përfaqësim të qarkut të tyre.

Marrëveshjet e zhvillimit të qarqeve pasqyrojnë të gjitha detyrimet financiare që kanë marrë përsipër palët, lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut.

(4) Këshillat e Bashkive/komunave që kanë marrë përsipër detyrime financiare në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit për Strategjinë e Zhvillimit të Qarkut nënkruajnë Marrëveshjen e Zhvillimit me Këshillin e Qarkut.

(5) Hollësitë në lidhje me mënyrën që pritet të negociohet dhe përfundohet Marrëveshja e Zhvillimit të Qarkut, objekti i saj i saktë dhe baza e financimit rregullohen me një vendim të Qeverisë.

V ZONAT E PAFAVORIZUARA

Neni 25

(Modeli i vlerësimit të nivelit të zhvillimit socio-ekonomik)

(1) Vlerësimi i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik bazohet në një indeks të zhvillimit socio-ekonomik të nxjerrë nga një numër treguesish socialë dhe ekonomikë.

(2) Natyra e saktë e modelit të përdorur, treguesit dhe rëndësia e tyre e përdorur në përpilimin e indeksit të vetëm të nivelit të zhvillimit social-ekonomik përcaktohet në një vendim të Qeverisë.

Neni 26

(Klasifikimi i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të qarqeve dhe komunave/bashkive)

(1) Vlerësimi dhe klasifikimi i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të qarkut dhe bashkisë/komunës kryhet nga ministria në baze të Modelit të Nivelit të Zhvillimit Social-Ekonomik të miratuar me vendimin e Qeverisë.

(2) Rivlerësimi i nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të qarkut dhe bashkisë/komunës kryhet në intervale pesë-vjeçare.

(3) Qarqet klasifikohen në grupet e mëposhtme, në pajtim me indeksin e tyre të zhvillimit social-ekonomik:

- Grupi I përbëhet nga qarqe vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është poshtë 75% të mesatares kombëtare;
- Grupi II përbëhet nga qarqe vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është ndërmjet 75% dhe 100% të mesatares kombëtare;
- Grupi III përbëhet nga qarqe vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është ndërmjet 100% dhe 125% të mesatares kombëtare;
- Grupi IV përbëhet nga qarqe vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është mbi 125% të mesatares kombëtare.

Një qark i pafavorizuar është ai që është klasifikuar në Grupin I.

(4) Njësitë e Bashkive/Komunave klasifikohen në grupet e mëposhtme, në pajtim me indeksin e tyre të zhvillimit social-ekonomik:

- Grupi I përbëhet nga komuna/bashki vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është poshtë 50% të mesatares kombëtare;
- Grupi II përbëhet nga komuna/bashki vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është ndërmjet 50% dhe 75% të mesatares kombëtare;
- Grupi III përbëhet nga komuna/bashki vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është ndërmjet 75% dhe 100% të mesatares kombëtare;

- Grupi IV përbëhet nga komuna/bashki vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është ndërmjet 100% dhe 125% të mesatares kombëtare;

- Grupi V përbëhet nga komuna/bashki vlera e indeksit të zhvillimit social-ekonomik të të cilëve është mbi 125% të mesatares kombëtare.

Një komunë/bashki e pafavorizuar është ajo që është klasifikuar në Grupet I ose II.

(5) Përcaktimi formal i qarqeve dhe bashkive/komunave si të pafavorizuara, në pajtim me këtë sistem klasifikimi, bëhet nga Qeveria. Vendimi i Qeverisë publikohet në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë".

(6) Ministria monitoron nivelin e zhvillimit social dhe ekonomik të qarqeve dhe komunave/bashkive çdo vit. Ajo mbledh gjithashtu të dhënat e nevojshme për monitorimin e nivelit të zhvillimit social-ekonomik. Me kërkesë të Ministrisë, organet e administratës shtetërore paraqesin regjistrat e tyre që përmbajnë të dhënat e nevojshme për monitorimin e nivelit të zhvillimit të qarqeve dhe komunave/bashkive.

(7) Njësitë e qarqeve dhe/ose bashkive/komunave që nuk vazhdojnë të përmbushin kriteret për statusin e zonave të diskriminuara e mbajnë atë status për një periudhë kalimtare prej një viti nga dita e miratimit të vendimit të klasifikimit të ri.

(8) Masat e veçanta për nxitjen e zhvillimit në qarqet dhe bashkitë e pafavorizuara rregullohen me vendim të Qeverisë.

VI FINANCIMI I NXITJES DHE ZHVILLIMIT RAJONAL NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Neni 27

(Burimet e financimit)

Fondet për financimin e politikave të zhvillimit kombëtar dhe rajonal përftohen nga: buxheti i shtetit, buxhetet e këshillave të qarqeve, buxhetet e këshillave të bashkive/komunave, fondet e para-aderimit dhe fondet strukturore të BE që i ofrohen Republikës së Shqipërisë, ndihma financiare e dhënë nga organizatat ndërkombëtare dhe burime të tjera financiare që janë në pajtim me ligjin.

Neni 28

(Financimi i dokumenteve të planifikimit në nivel qendror)

Përgatitja, hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit në nivel qendror financohet nga buxhetet e organeve administrative shtetërore qendrore dhe burime të tjera në pajtim me ligjin.

Neni 29

(Financimi i Strategjive të Zhvillimit të Qarqeve)

(1) Përgatitja dhe hartimi i Strategjive të Zhvillimit të Qarqeve financohet nga buxhetet e këshillave të qarqeve dhe bashkë-financohet nga buxhetet e komunave dhe bashkive, si dhe nga burime të tjera në pajtim me ligjin.

(2) Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit të Qarqeve financohet në pajtim me termat e Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarqeve.

VII MONITORIMI, VLERESIMI DHE RAPORTIMI

Neni 30
(Monitorimi)

Ministria monitoron zbatimin e SNZHR-së dhe zbatimin e Marrëveshjes së Zhvillimit të Qarqeve.

VIII DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 31

Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që brenda muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktet nenligjore të përcaktuara në nenet x, xx,dhe xxx të ligjit.

Neni 32
(Hyrja në fuqi)

Ky Ligj hyn në fuqi _____ dite pas botimit në fletoren zyrtare.